



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:1384/24, Datë: 12/07/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr.13/29 qershor 2023, Prishtinë), nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 124-të, mbajtur me datë 25.06.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren për periudhën **pesë (5) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2029):
 1. *Agrobiznes BSc 180 ECTS me kuotën maksimumi 80 studentë për vit akademik;*
 2. *Menaxhim në Agrobiznes MSc 120 ECTS me kuotën maksimumi 15 studentë për vit akademik.*
 3. *Gjuhë dhe Letërsi Shqipe BA 240 ECTS me kuotën maksimumi 40 studentë për vit akademik.*
 4. *Gjuhë dhe Letërsi Gjermane BA 180 ECTS me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik.*
- II. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren që deri më datë 15.11.2024 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshim të bartësve aprovet me vendim nga KSHC.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Agrobiznes BSc 180 ECTS R</i>	Isuf Lushi Festim Tafolli Nol Krasniqi
2.	<i>Menaxhim në Agrobiznes MSc 120 ECTS R</i>	Sadik Maloku Kushtrim Braha
3	<i>Gjuhë dhe Letërsi Shqipe BA 240 ECTS R</i>	Xhafer Beqiraj Teuta Kafexholli Vjollca Dibra Ibrahimi Manjola Brahaj
4	<i>Gjuhë dhe Letërsi Gjermane BA 180 ECTS R</i>	Ilir Krusha Izer Maksuti Elsev Brina Lopar

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *Agrobiznes BSc 180 ECTS***, me 04.04.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Hans Peter Kaul dhe Katerina Klimoska, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht pesë (5) dhe Substancialisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; *Menaxhim në Agrobiznes MSc 120 ECTS*** me 04.04.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Joachim Muller dhe Katerina Klimoska ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht katër (4) dhe Substancialisht tre (3) fusha të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; *Gjuhë dhe Letërsi Shqipe BA 240 ECTS***, me 29.04.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Dhurata Shehri dhe Giga Khositashvilli ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht katër (4) dhe Substancialisht tre (3) fusha të standardeve të akreditimit.

4. **Për programin e studimit; Gjuhë dhe Letërsi Gjermane BA 180 ECTS** më 29.04.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Georg Schuppener dhe Giga Khositashvilli ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit; ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht katër (4) dhe Substancialisht tre (3) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 124-të, të mbajtur më datë 25.06.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi i dërgohet:

- Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë